



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK) me qëllim të nderimit të mjekëve anëtar, për të arriturat e vërtetuara në fushën e mjekësisë, me kontributin e shprehur në nivel evropian dhe botëror për vitin 2022, duke u bazuar në Nenin 6 të Rregullores për dhënien e dekoratave dhe çmimeve vjetore, shpallë:

**THIRRJE PËR APLIKIM TË PËRKRAHJES FINANCIARE PËR ARRITJE SHKENCORE DHE INOVACION
PËR VITIN 2022**

Oda e Mjekëve të Kosovës i bënë thirrje mjekëve shtetas Kosovar, anëtar të OMK të konkurojnë për përfitimin e përkrahjes financiare për arritje shkencore dhe inovacion përgjatë vitit 2022. Aplikimi për arritje shkencore dhe inovacion do të vlerësohet dhe përzgjedhet nga Komisioni Ad-hoc përkatës dhe më pas do të caktohet edhe shuma e përkrahjes financiare, sipas planifikimeve buxhetore të OMK.

Kushtet dhe procedurat

Kriteret obligative të pranimit janë:

- Mjeku shtetas Kosovar duhet të jetë anëtar i Odës së Mjekëve të Kosovës;
- Mjeku duhet të posedojë licencë valide të punës;
- Mjeku duhet të posedojë certifikatë të kaluarës etike-profesionale nga organi kompetent i OMK.

Kriteret poentuese janë:

- Periudha kohore e patentimit të Inovacionit duhet të jetë përgjatë vitit 2022. Inovacioni të vërtetohet me: Certifikatë apo dokument të patentës së lëshuar nga autoriteti kompetent vendor ose ndërkombëtar si në vijim:
 - a) Vendor me 4 pikë;
 - b) Evropian ose SHBA me 6 pikë;
 - c) Vendet e tjera ndërkombëtare me 4 pikë.

- Numri i konferencave ndërkombëtare (1 pikë) ose i publikimeve në revista të indeksuara në Web of Science dhe Scopus (2 pikë), të ndërlidhura me inovacionin.

Mënyra e vlerësimit: Totali i pikëve do të llogaritet **përmes shumëzimit** të vlerave numerike të kritereve obligative dhe selektive të lartpërmendura (*).

**Nëse vlera numerike e kritereve obligative është 0 (zero), atëherë numri total i pikëve do të rezultojë me vlerë zero dhe aplikuesi do të eliminohet nga shqyrtimi.*

Koment shtesë:

Nëse në fund të listës së aplikuesëve të përzgjedhur rezulton më tepër se një aplikues me pikë të njejta, atëherë shumica e dedikuar ndahet në përpjestim të barabartë me numrin e aplikuesëve.

-Një aplikues ka të drejtë aplikimi me vetëm një arritje shkencore/inovacion.

Për të aplikuar, të interesuarit duhet të dërgojnë:

(I). Formularin për aplikim (e gjeni të bashkangjitur) dhe

(II). Dokumentet e lartcekura në kriteret obligative dhe poentuese.

Dokumentet mund të dërgohen përmes email adresës zyrtare të Odës: info@omk-rks.org duke shënuar në subjekt (subject) që jeni duke i'u përgjigjur thirrjes për përkrahje financiare të arritjes shkencore dhe inovacion. Të njejtat mund t'i dorëzoni në kopje fizike pranë zyreve të OMK-së, QKUK, Insitutet A, Kati III, 10 000, Prishtinë.

Afati për konkurim është i hapur nga data: 02 qershor 2023 deri 16 qershor 2023 në ora 16:00.

Për sqarime dhe pyetje në lidhje me konkurimin ju lutemi drejtoheni pranë zyrës ligjore të OMK-së: liridon.beha@omk-rks.org dhe asistentes mergime.krasniqi@omk-rks.org apo kontaktoni në numrin e telefonit 049-872-070.